

REFLEKSIONE MBI POEMËN *ANDRRA E JETËS TË NDRE MJEDËS*

Skënder DRINI

Një poet si Mjeda nuk mund të meritojë vetëm një vëmendje kronologjike dhe të kujtohet apo të merret nëpër duar vetëm në datat kalendarike të shënuara me të kuqe. Po ashtu, ai nuk mund të konsiderohet i shterruar në hapësirën e një shekulli, sepse shumëkush është marrë me të. Bindesh për sa më sipër duke lexuar parathënien e Anton Berishës, që i prin një botimi autentik të poemës *Andrra e jetës*. Kjo parathënie meriton vëmendje për seriozitetin e argumentave të përdorura nga autori, për një thyerje të njëfarë tabuje të analizave standarde mbi Mjedën dhe në mënyrë më të veçantë për raportin në mes të reales dhe joreales në veprën *Andrra e jetës*. Kjo poemë të huton disa herë duke menduar që i përket një brezi krijuesish romantikë, por nga ana tjetër të huton dhe të shkakton dilema se nuk mund ta vendosish me një siguri absolute në një prehër romantik. Kjo jo vetëm si një mirazh artistik të shkaktuar nga magjia artistike e penës së Mjedës, por edhe për faktin e mos-përputhjes së realitetit me shkollën

artistike mbizotëruese, me metodën artistike të kohës. Është e pamundur të gjendet një thërmi sentimentaliste te Mjeda, siç është e pamundur të gesh elemente të poezisë pastorale tradicionale mjaft në vogë për kohën. Mjeda mund të jetë një nga njohësit më të thellë të letërsisë latine dhe në mënyrë të veçantë të Virgjilit, po vepra e tij nuk ka asnjë reminishencë bukolike, gjë nga e cila nuk ka shpëtuar dot Naimi. Kjo është shprehja më bindëse e një autoriteti të madh origjinal, që nuk mund të rimorkohet nga asnjë lloj gjenialiteti i kaluar. Të krijohet përshtypja se Mjeda e ka të gatshme dhe të përcaktuar metodën apo shkollën letrare që do të përdori me gjinitë e mëdha të poezisë, lirikën dhe epikën. Kështu *Andrrën e jetës* ai do ta trajtojë si një neoromantik (besoj të mos dalim shumë jashtë orbitës mjediane me këtë emërtim), ndërsa *Lissus*, *Scodra* dhe *Lirija*, pra *epikën* do ta trajtojë si një klasik.

Mjeda e ka ngritur natyrën gjer në shkallën e një kulti. Edhe në kohën e Mjedës natyra ishte ajo që kishte qenë

prej miliarda vjetësh. Kishte pësuar di-
sa ndryshime kualitative, mbase ishte
zbutur edhe më shumë, por gjithsesi
natyra ishte gurë, ujë, qiell, bimë. Pra,
ishte diçka materiale. Ajo nuk ishte as
politeiste, as monoiste, as pagane, as
deiste. Ishte thjesht materiale. Po, në
çfarë raporti është bukuria e natyrës
së Mjedës me bukurinë e njeriut? Këtu
kemi diçka krejt të veçantë, sepse Mje-
da i vë përballë natyrës vetëm buku-
rinë shpirtërore të njeriut. Në rapsoditë
e Veriut ka portrete të mrekullueshme
të femrës që rivalizojnë një për një me
natyrën, portrete fizike. Tek Mjeda nuk
ndodh kjo. E pengon pekti fetar, apo
druhet se mos bukuria fizike eklipson
atë shpirtërore? Në të gjithë poemën e
Mjedës nuk gjen dy vargje që të merren
me bukurinë fizike të femrës. Vetëm në
imagjinatën për begun e ri, Mjedës si-
kur i ikën situata nga dora dhe ka një
shpërthim të befhtë dhe të fshehtë të
seksualitetit. Kultu i natyrës së Mjedës,
sa është barok në madhësinë e vet,
aq është fin, elegant dhe i hollë në
thelbin e vet. Eleganca e ndjenjës së tij,
qoftë ndaj natyrës, qoftë ndaj njeriut
të kujton Rilken. Mjeda duhet ta ketë
njohur Rilken. Është e pamundur që të
mos e ketë njohur. Duke qenë natyra
shumëçka në veprën e Mjedës, në një
vështrim të përciptë duket sikur e më-
njanon njeriun dhe subjektin, por duke
mënjanuar pak vargje të tepërta dhe
ndofta deskriptive në pjesën e dytë,
e kupton që nuk është kështu, sepse
e veçanta e Mjedës, e natyrës së tij,

shkon deri tek animizimi. As Tringa, as
Zoga, as Lokja nuk do të ishin Tringë,
Zogë dhe Loke jashtë mjediseve ku i
ka vendosur Mjeda. As ai gjel kokoti
maje plehut nuk do të kishte kurrfarë
rëndësie po të ishte vetëm lajmëtari i
prishjes së motit dhe po të mos e para-
lajmëronte prishjen e një jete njerëzore,
atë të Tringës. Ai të kujton saga kelto-
gotike ku paralajmëron drama të vër-
teta shekspiriane.

A dominon femra kundrejt për-
mbajtjes në artin e Mjedës tek *Andrra
e jetës*? Po të bësh një llogaritje banale,
më pak se një e katërta e vargjeve te
Andrra e jetës ngërthejnë subjektin dhe
pjesa tjetër është natyrë dhe konsidra-
cione. Në këtë raport a mos mbetet
Mjeda rob i mendimit të tij që poeti ka
për qëllim *me shëmbëllye bukurinë* dhe
se këtë mund ta arrijë më së tepërmi
përmes natyrës? E thjeshta tek Mjeda
është e përkryer, është *kreckë e bre përzi
me lisa* dhe përtej kësaj, po të shtosh
edhe një gjethe, shkatërron gjithçka.
Këtë bukuri të thjeshtë, që të duket se
shkon deri në zanafillën e natyrës, Mje-
da e kërkon gati me një stërmundim
patollogjik. Përsosmëria ka bërë që ai
të kapërcejë dekada dhe shkolla arti.
Kjo është një shenjë gjenialiteti po të
kujtosh që te Homeri ndesh tash e parë
elemente që e kapërcejnë antikitetin.

Mjeda merret me një familje pa një
zot shtëpie, pa një mashkull për t'i da-
lë zot. A duhet kërkuar pse ndodh kë
shtu? E ka fajin lufta? Gjakmarrja? Së-
mundjet? Këto nuk i kanë interesuar

Mjedës, derisa nuk i thotë. Ka imagjinuar një familje të pambrojtur dhe kaq. Gjithashtu mbase është edhe e tepërt të kërkosh një simbolikë fataliteti në një familje të braktisur nga rrethana të panjohura. Kjo sepse mund të ndodhi si me *Plaku dhe deti*, ku kritika u përpoq të gjente simbole për detin, peshkun dhe plakun, kur Heminguej, siç ka thënë vetë, nuk i kishte menduar si simbole.

Pse vdes Tringa? Vdekjes së saj i paraprin një dhimbje në bri, por kjo nuk mjafton për të spjeguar pse vdes Tringa. Këtu është e pamundur të mos kapërcesh disa vite për të arritur tek Migjeni. Ai do të na thoshte shkurt dhe rreptë që janë kushtet social-ekonomike dhe politike që e vdesin Tringën, është bukuria që vret. Ndër autorë të tjerë të huaj, natyra lebetitet në një rast analog me atë të Tringës, po te Mjeda nuk ndodh kjo. Krijuesi merret vetëm me Tringën dhe e lë natyrën të paprekur në të gjithë madhësinë dhe bukurinë e vet, e lë si një djep ku do të ngjizet një tjetër ëndërr. Dhe ajo vjen me Zogën. Për një çast, kur Zoga ëndërron begun në maje të kalit, të krijohet përshtypja

se poema mund të marri një kahje tjetër dhe një dimension të ri, por nuk ndodh kështu. Gjithçka është imagjinare, gjithçka shkimet në një drithrimë qerpiku, aq sa është lumturia e Zogës. Mjeda mendon për të një lumturi, pak më ndryshe nga ajo që mendon Zoga. Mendimi i saj nuk shkon larg gjithë brezit të saj që në një përfytyrim adoleshent modelojnë princin e kaltër. Ndërsa Mjeda është për një lumturi disi të nisur më radikalisht, për një lumturi më të sigurt, me unazë në gisht dhe me Krishtin dorëzanë, qoftë kjo edhe me atë begun nën balkon. Beg nuk është më një emër, po një mbiemër, një kualitet, një fisnikëri. Është pak a shumë si te *Mbreti i Tulës*, ku përdoret fjala *padisha*. Ka imperativin e rimës në këtë rast? Jo, se mund të gjente me qindra! Po mund të përdorte fjalën mbret, sulltan, perandor? Jo, se kërkonte një emër me një konatacion gati hyjnor.

Andrra e jetës është një vepër e nxjerrë nga dora e një mjeshtri të madh. Për nga eleganca, harmonia dhe finesa, pak vepra mund të qëndrojnë përkrah saj, qoftë edhe në plan evropian.